

Hyrje¹

Ky vit shënon tridhjetë vjetorin e botimit të numrit të parë të revistës *Studime për artin*, i cili doli në dhjetor të vitit 1995. Revista, që fillimisht nisi si projekt pilot, pasi numri i parë ishte konceptuar më shumë si një përmbledhje studimesh, me shpresën që në të ardhmen të shndërrohej në një botim të rregullt (vjetor), në rast se do të mund të siguroheshin burimet e qëndrueshme financiare për revistën,² është sot burimi kryesor i studimeve mbi historinë, praktikën dhe teorinë e artit modern e bashkëkohor shqiptar. Po ashtu, ajo që fillimisht ishte menduar si një hapësirë për të paraqitur punën kërkimore të studiuesve vendës, është kthyer në një hapësirë dinamike bashkëpunimi ndërkombëtar midis kërkuesve shqiptarë dhe kolegëve të tyre, që punojnë në vende të tjera të botës. Revista ka shënuar përparime të mëdha edhe në aspekte të tjera: *Studime për artin* është sot një revistë me qasje të hapur, boton artikuj në gjuhën shqipe e angleze dhe po ecën me hapa të sigurt drejt përfshirjes në bazat ndërkombëtare të të dhënave.

Ndërkaq, ky numër i revistës *Studime për artin* shënon përmbylljen e një harku tematik që ka përfshirë pesë numrat e

¹ Përkthyer në gjuhën shqipe nga Anxhela Çikopano.

² Shtypja e dy numrave të parë të revistës *Studime për artin* u bë e mundur, të paktën pjesërisht, nga një shtëpi botuese private.

Hyrje

fundit të revistës (nr. 19–23), të cilin redaksia e ka quajtur jozyrtarisht “cikli mbi kohësinë”. Synimi i këtij harku pesëvjeçar ka qenë të përpilojë një hartë vijimësish dhe thyerjesh të rëndësishme mes epokës socialiste dhe asaj post-socialiste në Shqipëri, përmes prizmit të artit dhe kulturës. Ai nisi, në dukje, në mënyrë të papritur ose disi paradoksale, me një numër të dyfishtë kushtuar arkivit, që hulumtonte vijimin e jetëve të së kaluarës socialiste në të tashmen neoliberales. Numri pasues i ktheu lexuesit e *Studimeve për artin* në fillimet e procesit, duke shqyrtuar përpjekjet e artistëve dhe punonjësve kulturorë shqiptarë (dhe jo vetëm) për të ripërcaktuar parametrat e artit dhe kulturës shqiptare gjatë momenteve kyçe të historisë moderne dhe bashkëkohore të vendit, veçanërisht në pikun e Revolucionit Ideologjik e Kulturor në fund të viteve '60 dhe fillim të viteve '70, si dhe në periudhën pas rënies së regjimit komunist në fillim të viteve '90. Dështimi i përmbushjes së këtyre “fillimeve të reja” ashtu siç ishin premtuar, u trajtua në numrin mbi revizionizmat, i cili shqyrtoi rikthimin te tropet nacionaliste në kohë krizash, si gjatë periudhës socialiste, ashtu edhe në atë post-socialiste. Logjikisht, numri i këtij viti përqendrohet te mbylljet. Më saktë, ai përqendrohet te dekada e fundit e periudhës socialiste dhe te produktet kulturore që, në një mënyrë apo në një tjetër, parashikuan rënien e projektit socialist, që sa vinte e po afrohej.

Numri hapet me artikullin e Vincent W.J. van Gerven Oei, “Albanofuturism and Star Death” (“Albanofuturizmi dhe vdekja e yjeve”), që shqyrton lindjen dhe zhvillimin e letërsisë fantastiko-shkencore në Shqipëri në lidhje me angazhimin e vendit në lëvizjet antikoloniale në Botën e Tretë, pas prishjes me Moskën në fillim të viteve '60, një riorientim që u paraqit si

Hyrje

zgjerrim i qëndrimit anti-imperialist të vendit dhe që zgjati përgjatë viteve '70 e deri në vitet '80. Ajo që e bën letërsinë fantastiko-shkencore veçanërisht interesante si fenomen kulturor të shoqërisë shqiptare të socializmit të vonë, është fakti se në një kuptim ajo përfaqëson përpjekjen e fundit për t'i dhënë një shprehje të besueshme utopizmit radikal që kishte karakterizuar realizmin socialist, gjë që po bëhej gjithnjë e më e vështirë me shuarjen e perspektivës së revolucionit botëror, ndërsa sillte edhe hapësira për të menduar “jetën pas vdekjes ideologjike” (f. 35). Në sfondin e izolimit gjithnjë e më të madh të Shqipërisë, jo vetëm nga perëndimi kapitalist por edhe nga lindja socialiste, udhëtimi në hapësirë u bë mjet për të mbajtur gjallë idealet e solidaritetit dhe vëllazërisë socialiste, duke i projektuar ato në të ardhmen dhe në qytetërimi jashtëtokësore në skajet e kozmosit. Nga ana tjetër, motivi i përsëritur i “vdekjes së yjeve” që përshkon këtë zhanër të vogël letrar, nënkupton mundësinë e dështimit të projektit socialist në të tashmen.

Pas tij vjen artikulli i Anxhela Çikopanos, “The Perfect Parasite Lives in Apartment Block 176” (“Paraziti i përkryer jeton në pallatin nr. 176”), ku trajtohet *Pallati 176*, që është ndoshta komedia më e njohur shqiptare e të gjitha kohërave. Autorja e gjen arsyen e popullaritetit të jashtëzakonshëm të pjesës, e cila e shfaq premierën në vitin 1986, në mënyrën se si rivendikohet figura e “parazitit shoqëror”, figurë që mishërohet nga protagonistin i dashur i pjesës, Jovan “Vani” Bregu. Mjeshtërisht i interpretuar nga Roland Trebicka, Vani është një punëtor dembel që ëndërron t'i shpëtojë punës fizike dhe nuk ka skrupuj për të dhënë ryshfete e për të mashtruar, në mënyrë që të arrijë postin e magazinierit. Çuditërisht, në fund të pjesës, Vani

Hyrje

arrin më shumë se ç'mendonte, jo pavarësisht, por pikërisht për shkak të mashtrimeve e mekanizmave që përdor për t'u ngjitur në hierarkinë shoqërore. Në veçanti, zinxhiri i ngjarjeve që vë në lëvizje Vani kur ulet të shkruajë famëkeqen “letër anonime” për të shantazhuar drejtorin e ndërmarrjes shtetërore ku punon, mund të lexohet si një alegori e teorisë marksiste të mbivlerës, duke parathënë kështu kolapsin e afërt të socializmit shtetëror dhe rivendosjen e rendit kapitalist, që do të ndodhte në fund të dekadës. Klasa burokratike, ku Vani ëndërron të bëjë pjesë, do të shndërrohej shumë shpejt nga borgjezi socialiste në klasën e re kapitaliste, sipërmarrëse të viteve '90.

Borgjezia, qoftë në variantin e saj “të kuq” socialist, apo në atë “të zi” kapitalist, është tema e artikullit të Enis Sulstarovës, “Borgjezi e kuqe, borgjezi e zezë: Perceptime mbi fundin e socializmit në romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* të Ismail Kadaresë”. Analiza e Sulstarovës vë në pah mënyrën se si Kadareja e përvetëson në mënyrë strategjike ligjërimin orientalizues që regjimi komunist shqiptar përdorte ndaj borgjezisë së paraluftës, pra ndaj “borgjezisë së zezë”, për ta shtrirë atë mbi ish aleatët e Shqipërisë në botën socialiste, konkretisht Bashkimin Sovjetik dhe Republikën Popullore të Kinës, me pretekstin se politika revizioniste e këtyre vendeve kishte sjellë lindjen e një “borgjezie të kuqe”, që do të çonte në rivendosjen e kapitalizmit. Kjo çoi në ndalimin e *Koncertit në fund të dimrit* në vitin 1983, megjithëse romani u botua pesë vjet më vonë. Sulstarova e lexon botimin e romanit në vitin 1988 si një shenjë të afrimit jo të largët të Shqipërisë me perëndimin kapitalist, duke parashikuar edhe mënyrat se si orientalizmi do të riformulohej në ligjërimin publik shqiptar pas rënies së

socializmit shtetëror. Kështu, një nga objektivat kryesorë të orientalizmit shqiptar në periudhën post-socialiste do të bëhej vetë e kaluara socialiste, duke u shndërruar në një instrument të rëndësishëm të reformave neoliberales.

Në fillim të viteve '90, utopia e kufijve të hapur u përball me përvojën traumatike të emigrimit dhe me regjimet e vizave të vendosura nga shtetet e tjera. Kjo është tema e raportit të Ervin Shehut mbi Arkivin e Emigracionit Shqiptar – një projekt pilot i Arkivit të Historisë Sociale Bashkëkohore (ASKI) në Athinë, Greqi. Në analizën e tij mbi këtë ndërmarrje të re arkivore dhe ekspozitën që e shoqëron, “Një çantë plot me karta telefoni: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar” (TAVROS, 18–28 shtator 2024), Shehu shpreh një optimizëm të kujdesshëm mbi potencialin emancipues të arkivave dhe ekspozitave të emigracionit, që krijohen me pjesëmarrjen e vetë emigrantëve dhe që, nga ana tjetër, synojnë ta kthejnë vizitorin në pjesëmarrës aktiv. Duke u dhënë zë përvojave të ndërlikuara të emigrimit, këto arkiva e ekspozita mund të shndërrojnë kujtesën kolektive në një mjet jo vetëm për të korrigjuar padrejtësitë historike, përmes një rishikimi kritik të së kaluarës, duke u larguar nga narrativat që e demonizojnë ose e viktimizojnë komunitetin emigrant, apo që e depolitizojnë përmes asimilimit, por edhe për të artikuluar imagjinata politike alternative për të ardhmen.

Numri mbyllet me dy recensione. I pari është recension i prekës i Bruce Williams mbi librin *Ditari i një kinoregjisori* (Tiranë: Muza Printing, 2024), me kujtimet e Endri Kekos, një prej pionierëve të filmit dokumentar shqiptar dhe një nga themeluesit e Kinostudios “Shqipëria e Re”. I dyti është recension i Artan Hoxhës mbi monografinë e studiueses Agata

Hyrje

Fijalkowski, *Law, Visual Culture, and the Show Trial* (*Ligji, kultura pamore dhe gjyqet publike*, Abingdon dhe Nju Jork: Routledge, 2023), të cilin Hoxha e sheh si një paralajmërim për tendencën ndër studiuesit e huaj për të bërë kërkime të cekëta mbi Shqipërinë, por edhe si një thirrje për studiuesit shqiptarë që të prodhojnë punime të një niveli më të lartë shkencor.

Studime për artin do ta pasojë “ciklin mbi kohësinë” me një numër të dyfishtë kushtuar temës së pjesëmarrjes e kolektivitetit dhe mënyrave të shumta me të cilat arti në Shqipëri dhe në kontekste të ngjashme gjeografike e historike ka kontribuar në forma të reja të pjesëmarrjes dhe kolektivitetit gjatë shekullit XX e deri në ditët e sotme.

Jonida Gashi
(*Kryeredaktore*)